



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of
Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja c të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 2, paragrafi 2.3, nenit 8, shkronja i, nenit 15, shkronja f të Ligjit nr. 03/L - 049, për financat e pushtetit lokal, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja c e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.05.2018, miratoi këtë

R R E G U L L O R E
PËR TË HYRAT VETANAKE TË INSTITUCIONEVE KULTURORE
VARTËSE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

Neni 1
Qëllimi

Në bazë të kësaj rregulloreje përcaktohen burimet, qeverisja dhe shpenzimi i të hyrave vetanake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës.

Neni 2
Objekt i rregullimit

Institucione kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës, konsiderohen të gjitha institucionet kulturore të themeluara nga Komuna e Prishtinës sipas Ligji nr. 02/L-57 për institucionet e kulturës, institucionet kulturore të themeluara sipas ligjeve të veçanta për institucionet e kulturës, dhe institucionet tjera që janë në vartësi të Drejtorisë së Kulturës të Komunës së Prishtinës.

Neni 3
Burimi, qeverisja dhe shpenzimi i të hyrave vetanake, burimet e të hyrave.

3.1. Institucionet kulturore vartëse të shënuara më poshtë, kanë burime të të hyrave vetanake si në vijim:

3.1.1 Arkivi Komunal;

3.1.2 Biblioteka komunale "Hivzi Sulejmani";

3.1.3 Teatri i qytetit të Prishtinës "Dodona";

3.1.4 Institucionet kulturore komunale të themeluara nga Komuna e Prishtinës sipas ligjeve në fuqi.

3.2. Të gjitha të hyrat vetanake të institucioneve kulturore vartëse, konsiderohen të hyra vetanake të Komunës, por që njëherësh janë të hyra të dedikuara për institucionet përkatëse kulturore.

3.3. Për shërbimet bibliotekare lirohen nga pagesa:

3.3.1. Anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve,

3.3.2. Invalidët dhe veteranët e luftës së UÇK-së (familja e ngushtë),

3.3.3. Personat me nevoja të veçanta,

3.3.4. Personat me asistencë sociale,

3.3.5. Parashkollorët, fëmijët bonjakë (të braktisur) dhe pensionistët,

3.3.6. Lexuesit e degëve të bibliotekës në fshatra,

3.3.7. Anëtarësimi në datat kalendarike ndërkombëtare të librit,

3.3.8. Dhuruesit e gjakut,

3.3.9. Punonjësit e bibliotekës (familja e ngushtë).

3.4. Nga pagesa e qirasë për shfrytëzim të hapësirës dhe lokacioneve të dhëna me qira, në bazë të kërkesës së të apostrofuarve në vazhdim dhe dhënies së pëlqimit nga Drejtoria e Kulturës, lirohen:

a) Institucionet shtetërore qendrore dhe lokale,

b) Organizatat joqeveritare për personat me nevoja të veçanta,

c) Organizatat të cilat ushtrojnë aktivitetet jofitimprurëse dhe që konsiderohen me interes publik.

Neni 4

Mënyra e arkëtimit të mjeteve vetanake

4.1. Institucioni kulturor vartës është i obliguar që grumbullimin e mjeteve vetanake ta bëjë në mënyrë transparente, duke zbatuar procedurat e Ligjit për financat e pushtetit lokal.

4.2. Trajtimi, kontabiliteti, raportimi, monitorimi dhe verifikimi i pagesave do të bëhet në përputhje me Ligjin për financat e pushtetit lokal.

Neni 5

Angazhimi i personelit të institucionit dhe i personave jashtë institucionit kulturor

5.1. Personeli i institucionit kulturor vartës me orar të plotë të punës, për punën prodhuese dhe kryerjen e shërbimeve, mund të angazhohet në punën shtesë, sipas dispozitave të Ligjit nr. 03/L - 122, për punë dhe dispozitave të Ligjit nr. 03/L - 149, për shërbimin civil të Kosovës.

5.2. Institucioni kulturor vartës, sipas nevojës, mund të angazhojë edhe fuqi tjetër punonjëse jashtë institucionit. Ky angazhim bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit të punës.

5.3. Personelit të angazhuar në institucionet kulturore për kryerjen e shërbimeve dhe të prodhimeve, pagesa për punën shtesë i bëhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë punën shtesë.

5.4. Punonjësit të angazhuar jashtë institucionit kulturor, pagesa do t'i takojë në pajtim me dispozitat e Ligjit të punës, që kanë të bëjnë me personin e angazhuar.

Neni 6

Pagesat nga prodhimi ose krijimtaria

Produktet e prodhuara dhe të krijuara nga institucioni kulturor vartës, do t'i nënshtrohen shitjes në bazë të procedurave të parapara me ligj.

Neni 7

Pagesat sipas shërbimeve të institucioneve

7.1. Arkivi Komunal vjel:

7.1.1. Të hyra nga rregullimi i fondit arkivor:

6.1.1.1. Rregullimi regjistratori, për 1 m gjatësi;

6.1.1.2. Rregullimi arkivor, për 1 m gjatësi;

7.1.2. Të hyra nga përpunimi i regjistrit të kategorive me afate të ruajtjes sipas nomenklaturave bashkëkohore informative;

7.1.3. Të hyra në bazë të Rregullores mbi mënyrën e evidentimit, regjistrimit të materialit arkivor të parregulluar;

7.1.4. Të hyra nga kërkesat e palëve për lëndë arkivore;

7.1.5. Të hyra nga fotokopjimi, verifikimi dhe vërtetimi, për një fletë, sipas formatit të letrës:

7.1.5.1. A4;

7.1.5.2. A3;

7.1.5.3. A0;

7.1.6. Të hyra nga njoftimi me shkrim për personat fizikë;

7.1.7. Të hyra nga njoftimi me shkrim për institucione, ente etj.;

7.1.8. Të hyra nga certifikata me nota;

7.1.9. Të hyrat nga certifikata pa nota;

7.1.10. Skanimi i një dokumenti;

7.1.11. Të hyra tjera të aprovuara nga Komuna e Prishtinës.

7.2. Biblioteka komunale "Hivzi Sulejmani" vjel:

7.2.1. Të hyra nga anëtarësimi i lexuesve:

7.2.1.1. Anëtarësimi për fëmijë (klasa I - IX), për një vit;

7.2.1.2. Anëtarësimi për të rritur, për një vit;

7.2.1.3. Anëtarësimi për sallat speciale të punonjësve shkencorë, për 1 vit;

7.2.2. Të hyra nga masat ndëshkuese të përdoruesve të bibliotekës:

7.2.2.1. Në rast të humbjes apo thyerjes së librezës, duhet të nxirret librezë e re, duke paguar 50 % të çmimit kushtues të librezës origjinale;

7.2.3. Të hyra nga fotokopjimi i materialeve:

7.2.3.1. Formatit A4;

7.2.3.2. Formatit A3;

7.2.3.3. Të hyra nga shfrytëzimi i Sallës kamertale, Sallës së konferencave dhe hapësirës së arteve:

7.2.3.3.1. Për 1 orë;

7.2.3.3.2. Për 2 orë;

7.2.3.3.3. Për më tepër se dy orë;

7.2.3.3.4. Për tërë ditën;

7.2.3.4. Të hyrat nga qiraja (bufeja);

7.2.3.5. Të hyra të tjera të aprovuara nga Komuna e Prishtinës.

7.3. Teatri i qytetit të Prishtinës "Dodona" vjel:

7.3.1. Të hyra nga shfrytëzimi i Sallës universale, në kohëzgjatje deri në 3 orë e 30 min., nënkuptuar periudhën e përgatitjes së sallës, kohën e programit dhe kohën e nevojshme për largim nga objekti;

7.3.2. Të hyra nga shfrytëzimi i Sallës B, për termin ditor, pa pajisje shtesë;

7.3.3. Të hyra nga shitja e biletave;

7.3.4. Të hyra të tjera të aprovuara nga Komuna e Prishtinës.

7.4. Të hyrat të tjera që mund t'i vjelin institucionet kulturore komunale:

7.4.1. Të hyra nga shitja e biletave;

7.4.2. Të hyra nga shitja e suvenireve dhe materialeve promocionale;

7.4.3. Të hyra nga qiraja dhe dhënia për shfrytëzim e hapësirave, sipas ligjeve në fuqi;

7.4.4. Të hyra të tjera të aprovuara nga Komuna e Prishtinës.

7.5. Institucionet kulturore komunale i përpilojnë listat e tyre të shërbimeve, përfshirë çmimoren dhe përshkrimin e shërbimit dhe e dërgojnë për miratim në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

7.6. Komuna e Prishtinës pas miratimit të listave të shërbimeve dhe çmimeve, është e obliguar t'i bëjë publike ato në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës, kurse institucionet kulturore vartëse duhet ta kenë të dukshme për publikun këtë listë me çmime në ambientet e tyre të veprimit.

Neni 8

Qeverisja me të hyrat vetanake

8.1. Mjetet vetanake të grumbulluara nga pagesat, shpërndahen në pozicionet:

1. shërbime dhe mallra,
2. shpenzime kapitale,
3. kompensim për personelin e angazhuar.

8.2. Pas ndarjes së mjeteve për pagesë personelit të angazhuar, pjesa tjetër ndahet për shërbime dhe mallra dhe shpenzime kapitale, sipas nevojës.

Neni 9

Shfrytëzimi i mjeteve vetanake

Institucioni kulturor mund t'i shfrytëzojë mjetet vetanake për:

- a) mirëmbajtjen e mjeteve, pajisjeve, renovimin e objektit dhe zgjerimin e veprimtarisë së institucionit,
- b) furnizim me pajisje dhe literaturë profesionale,
- c) aftësimin e punonjësve në institucionet kulturore,
- d) ekskursione profesionale, panairë, shkëmbim përvojash etj.,
- e) organizimin e garave nga vetë institucioni (në nivel vendi, rajoni apo ndërkombëtar),

- f) shpërblime vjetore dhënë lexuesve me më së shumti libra të lexuar në bibliotekë gjatë vitit,
- g) projekte të cilat ndikojnë në ngritjen e punës arsimoro - edukative dhe profesionale të institucionit kulturor.

Neni 10 Mbikëqyrja

- 10.1. Komuna do ta mbikëqyrë punën e institucionit kulturor lidhur me sigurimin e burimeve, qeverisjen dhe shpenzimin e mjeteve vetanake.
- 10.2. Institucioni kulturor do të mbajë dokumentacionin përkatës në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 11 Raportimi

Institucionet kulturore raportojnë në baza mujore te Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 12 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-020/01-134849/18, më 06.06.2018



KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta